



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 45 regjistër (JR)
Datë 11.11.2024

Nr. 15 i vendimit
Datë 11.02.2026

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 11.02.2026, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Seladin Pysqyli, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 788, datë 25.07.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Seladin Pysqyli.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, neni F i Aneksit të Kushtetutës; nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe neni 51/1 i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 788, datë 25.07.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Seladin Pysqyli (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ai ka plotësuar dhe ka dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
2. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit të kryer për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: (a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (b) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”); dhe (c) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), prej të cilave rezultoi si më poshtë.
3. ILDKPKI-ja ka përcjellë në Komision raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar më datë 27.03.2018, nëpërmjet të cilit ka bërë analizimin e të dhënave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit me informacionet e ardhura nga institucionet përkatëse, në të cilin është konkluduar se:
 1. *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
 2. *Ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
 3. *Ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite;*
 4. *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
 5. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Në datën 08.07.2024, pasi ka zhvilluar hetimin administrativ për të tria kriteret, Komisioni i ka dërguar subjektit rezultatet e hetimit administrativ dhe i ka njoftuar të drejtën për sjelljen e provave dhe shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës së provës, të drejtën për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit të rivlerësimit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

5. Më datë 25.07.2024, në Komision u zhvillua seanca publike për shpalljen e vendimit për subjektin e rivlerësimit. Me vendimin nr. 788, datë 25.07.2024, Komisioni ka arritur në përfundimin që për subjektin të merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, mbi bazën e këtyre konkluzioneve:

5.1 Për kriterin e pasurisë: *“Në përfundim të analizës financiare të kryer nga Komisioni për verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ndodhen në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara, në kuptim të pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016. Në rastin konkret, pamjaftueshmëria financiare për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të, e konsideruar së bashku me përpjekjen e subjektit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave lidhur me pasurinë e ndodhur në Tiranë, çojnë trupin gjykues në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, lidhur me kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016”.*

5.2 Për kriterin e kontrollit të figurës: *“Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin Dh të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës”.*

5.3 Për kriterin e aftësive profesionale: *“Trupi gjykues, bazuar në konstatimet e mësipërme, argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pas një analize në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues”.*

6. Kundër këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim¹ brenda afatit ligjor, nëpërmjet të cilit kërkon:

6.1 Kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes që lidhet me rivlerësimin e tij kalimtar;

6.2 Ndryshimin e vendimit nr. 788, datë 25.07.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit z. Seladin Pysqyli, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

¹Ankimi datë 30.10.2024, protokolluar në Komision me nr. {***} prot.

II. Mbi ankimin dhe shkaqet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit

7. Më datë 30.10.2024, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë ankim kundër vendimit të Komisionit brenda afatit ligjor. Shkaqet e ankimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si në vijim.

A. Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurisë

7.1. *Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 134.57 m², në {***}, Tiranë, në shkaqet e ankimit, subjekti i rivlerësimit fokusohet në disa zëra.*

(i) Ai shprehet se është i gabuar qëndrimi i Komisionit për të (i) mos i llogaritur asnjë të ardhur nga familja bujqësore, duke potencuar se familja e tij bujqësore ka përfituar 20.000 m² tokë arë, vreshta e pemëtore, të cilat janë punuar rregullisht nga anëtarët e familjes ndër vite, duke siguruar të ardhura që kanë shërbyer për përballimin e jetesës dhe krijimin e kursimeve. Gjithashtu, subjekti pretendon se janë shitur kafshët shtëpiake, nga të cilat janë përfituar të ardhura në shumën 200.000 lekë.

(ii) *Lidhur me depozitat e kursimit*, subjekti pretendon se Komisioni nuk ka përlllogaritur saktë të ardhurat nga interesat e depozitave për periudhën 2005 – 2015.

(iii) *Lidhur me shpenzimet e udhëtimit*, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk janë përlllogaritur saktë nga Komisioni.

(iv) *Lidhur me gjendjen cash*, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni duhej të përlllogariste si shtesë kursimesh *cash* balancat pozitive të viteve në analizën financiare.

(v) Sa i përket analizës financiare për periudhën 2003 – 2016, subjekti pretendon se rezulton të jetë pozitive dhe jo negative siç ka konkluduar Komisioni.

7.2. *Lidhur me pasurinë “shtëpi banimi së bashku me truall me sip. 400 m²”, subjekti i rivlerësimit pretendon se analiza financiare në Komision duhej të kryhej për të gjithë periudhën nga 1993 deri më 31.12.2002, dhe jo e ndarë në dy periudha. Pretendimet e tij në ankim fokusohen në argumentet se:*

Komisioni nuk i ka përlllogaritur të ardhurat nga interesat bankare për periudhën 1993 – 2002:

(i) Nuk janë njohur nga Komisioni të ardhurat bujqësore e blegtorale, megjithëse familja ka përfituar tokë e pasuri nga ish-kooperativa bujqësore;

(ii) Kostoja e shtëpisë, ndryshe nga sa ka përlllogaritur Komisioni, ka qenë rreth 500,000 lekë, pasi materialet kryesore për ndërtimin e saj janë përfituar nga ish-kooperativa bujqësore.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

i. Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni

179/b, pikat 3 dhe 4. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, me objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin dhe shkarkimin nga detyra të subjekti rivlerësimi, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit. Shqyrtimi i ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit kryhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

9. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* dhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, ankimi është depozituar brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

10. Në përputhje me nenin 65, pika 1² e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë dorëzuar me ankimin akte për administrimin e tyre nga Kolegji në cilësinë e provës. Në datën 02.02.2026, subjekti i rivlerësimit ka depozituar parashtrime në lidhje me ankimin kundër vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit. Këto parashtrime nuk shoqërohen me akte. Subjekti i rivlerësimit kërkon ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë. Për sa më sipër, në kushtet që nuk përmbushet asnjë prej kriterëve që kërkon neni 51 i ligjit nr. 49/2012³, qoftë në planin e nevojës për të korrigjuar shkelje procedurale apo për të konstatuar rrethanat e faktit, në seancë gjyqësore publike në praninë e subjektit, çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për shkaqet e ankimit

*B.I. Apartamenti me sip. 134.57 m², ndodhur në {***}, Tiranë*

11. Ky apartament, në pronësi të djalit të subjektit, deklarohet në vlerën 5.600.000 lekë. Në deklaratën *vetting*, subjekti shprehet se i ka dhënë djalit 5.200.000 lekë për blerjen e një apartamenti në {***}. Këto veprime janë kryer pjesërisht me këste, në bazë të kontratës premtim-shitje dhe pjesën tjetër në kohën e lidhjes së kontratës. Shuma është siguruar duke tërhequr depozitat e kursimit nga BKT-ja dhe Union Bank. E njëjta situatë rezulton nga deklarata e djalit të subjektit, i cili ka referuar edhe kontratën noteriale nëpërmjet të cilës është fituar apartamenti [nr. {***} rep., nr. {***} kol.] në datën 09.03.2015. Burim deklarohen të ardhurat nga prindërit, në shumën totale prej 5.200.000

² “[...] Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

³ “[I.] Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë. [...]”.

lekësh, ndërsa 400.000 lekë kanë qenë të tij “nga lojërat e fatit”. E njëjta situatë rezulton edhe në deklaratën periodike vjetore. Personi i lidhur / djali i subjektit ka paguar një shumë prej 400.000 lekësh që deklaroi ta ketë pasur dhe deklaruar më parë, kurse pjesa tjetër prej 4.920.000 lekësh është paguar nga prindërit e tij. Po aty, ai shprehet se fillimisht subjekti / i ati ka paguar një shumë prej 280.000 lekësh, në vitin 2014, në bazë të kontratës së sipërmarrjes datë 04.01.2014, kurse pjesa tjetër gjatë vitit 2015.

11.1. Komisioni ka konkluduar se veprimet e subjektit për të deformuar të vërtetën lidhur me këtë pasuri, përfaqësojnë përpjekje të tij për të justifikuar mungesë burimesh të ligjshme që rezultojnë të shoqëruara me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagimin e pasurisë. Në këtë konkluzion, Komisioni ka mbajtur në konsideratë që subjekti ka fituar këtë pasuri në $\frac{1}{2}$ e çmimit, ndërsa çmimi i dakordësuar në kontratë korrespondon me tërheqjet bankare të tij në shumën 5.2 milionë lekë. Veprimet e kryera përpara shitblerjes, që sipas subjektit lidheshin me hua nga palët, nuk përputhen me faktet reale dhe historikun e transaksioneve. Komisioni ka konstatuar se marrëveshja e palëve ka pasur për qëllim shmangien e deklarimit të vlerës reale të përfitimit të kësaj pasurie. Subjekti nuk ka provuar të kundërtën e barrës së provës për ligjshmërinë e veprimeve të kryera për përfitimin e kësaj pasurie, të analizuar sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës. Komisioni, po ashtu, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të ardhurat e deklaruara dhe pretenduara të krijuara nga bujqësia, duke rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të përballuar pagimin e pasurisë objekt hetimi, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

11.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit me argumentet e përmbledhur më sipër, të cilat fokusohen kryesisht në aspektin financiar dhe konkretisht: në të ardhurat nga bujqësia, interesat e depozitave, shpenzimet e udhëtimit, gjendjen *cash* dhe analizën financiare. Subjekti pretendon se rezulton me balancë pozitive dhe jo negative siç ka konkluduar Komisioni.

11.3. Pasi shqyrtoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konkludoi që konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri është i bazuar. Edhe në analizën e kryer në Kolegj për efekt të kontrollit të analizës financiare të Komisionit, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Mungesa e burimeve financiare të ligjshme qëndron, pavarësisht nga korrektimet e kryera në Kolegj mbi bazën e shkaqeve të ankimit që u vlerësuan të bazuara. Ky konkluzion mban në konsideratë sa vijon:

10.3.i. Subjekti nuk arriti të provojë të ardhurat e pretenduara nga prodhimet bujqësore, si burim për krijimin e kësaj pasurie. Nga ana tjetër, çmohet të theksohet se Komisioni ka pranuar ekzistencën e të ardhurave nga aktiviteti bujqësor, më së paku në masën që janë reduktuar shpenzimet e jetesës për ekonominë familjare të subjektit dhe personave të lidhur, në masën 47.5% [më pak se $\frac{1}{2}$ e tyre] të standardit të INSTAT për frymë. Edhe në vlerësimin e Kolegjit, subjekti është i pabesueshëm në pretendimet e tij për sasi të ndryshme të ardhurash të gjeneruara nga aktiviteti bujqësor, gjatë deklarimeve periodike vjetore, krahasuar me vlerat e pretenduara gjatë hetimit administrativ në Komision që janë mbi dyfish më të larta. Në kushtet që për të ardhurat e

pretenduara në aktin e ekspertimit nuk ka asnjë gjurmë dokumentare, qoftë edhe indirekte, ndërsa subjekti ka deklaruar të ardhura vetëm për vitet 2007 e në vijim, në sasi që variojnë nga 90.000 lekë në 250.000 lekë në vit, pretendimet e subjektit u vlerësuan të pabazuara. Po ashtu, duke qenë se Komisioni ka zbritur në mënyrë të konsiderueshme shpenzimet e jetesës për *gjithë* periudhën, ndonëse subjekti ka deklaruar të ardhura vetëm për nëntë vitet, 2007 – 2016, nën dritën e garancive procedurale në ankim, vlerësimi i Komisionit se subjekti është përpjekur të deformojë të vërtetën e paraqesë fakte në favor të situatës së pafavorshme financiare, u konfirmua edhe në Kolegj.

10.3.ii. Balanca negative që rezulton, është rezultat i qasjes më të favorshme, sipas çmimit të pasqyruar në kontratën e shitjes, 5.600.000 lekë, e që përkon thuajse tërësisht me shumën e likuiditeteve të tërhequra nga subjekti në periudhën kur është blerë apartamenti, ndonëse në gjithë transaksionet e dokumentuara për këtë pasuri në tre vitet pararendëse, 2012 – 2015, çmimi i tij ishte 73.000 euro.

10.3.iii. Trupi gjykues korrektoi shumën e likuiditeteve të deklaruara në vitin 2003, duke marrë në konsideratë gjendjen e tyre, përkatësisht me efekt në analizën për vitet 1993 – 2002 dhe 2003. Nga ky korrektim, ndonëse u zvogëluar balanca negative e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, ajo gjithsesi mbeti e konsiderueshme. Në këtë analizë, sikurse edhe Komisioni, trupi gjykues e gjeti të bazuar vlerësimin e Komisionit për mënyrën e përlllogaritjes së likuiditeteve *cash* të kursyera, bazuar në deklaratat periodike vjetore.

11.4. Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton sa vijon:

a. kontrata noteriale e sipërmarrjes është hartuar në datën 15.02.2012⁴, mes shoqërisë ndërtuese dhe një individi [z. F. T.]. Palët kanë rënë dakord për çmimin e pasurisë në vlerën 73.034 euro. Me deklaratën noteriale datë 02.03.2012, shoqëria ndërtuese deklaroi se është likuiduar totalisht nga porositësi. pasi shumën është marrë e plotë dhe nuk ka asnjë pretendim në lidhje me këtë shumë. Në datën 27.03.2012, është lidhur kontrata paraprake e shitjes për apartamentin, sipas së cilës porositësi i ka shitur një personi tjetër [z. A. G.] apartamentin në shumën 73.034 euro. Paga është likuiduar tërësisht nga blerësi, ndërsa shoqëria ndërtuese ka shprehur dakordësinë e saj lidhur me këtë transaksion.

b. Në datën 09.03.2015, pranë të njëjtës notere, është lidhur kontrata noteriale e shitjes, në të cilën si palë shitëse shfaqet shoqëria ndërtuese [{"***"}] ShPK, përfaqësuar nga z. E. B., ndërsa në cilësinë e palës blerëse shfaqet djali i subjektit, z. O. P. Apartamenti referohet i shitur kundrejt çmimit prej 5.600.000 lekësh.

c. Në të njëjtën datë, më 09.03.2015, tek e njëjta notere, është nënshkruar deklarata noteriale ndërmjet palëve A. G. dhe E. B., sipas së cilës E. B. deklaroi se i ka marrë hua shumën 73.000 euro z. A. G.

d. Referuar të dhënave të QKB-së, duke filluar nga data 11.2.2015, shoqëria ndërtuese është urdhëruar të mos kryejë asnjë veprim për shkak të kërkesës për vendosjen e barrës së sigurisë mbi titujt e pronësisë. Më fjalë të tjera, ditën e nënshkrimit të kontratës së shitjes, më 09.03.2015, midis

⁴ Nr. {***} rep., nr. {***} kol., ndërmjet shoqërisë [{"***"}] ShPK, përfaqësuar nga z. E. B.

djalit të subjektit dhe shoqërisë ndërtuese, kjo e fundit ka qenë e bllokuar dhe nuk mund të kryente asnjë veprim.

e. Shumat e tërhequra në datën 06.01.2015 nga bankat, në vlerën në total prej përreth 4.8 milionë lekësh (rrumbullakosur), përbërë nga dy depozita të ndryshme, origjinon nga një sërë depozitimesh në *cash*, në vlera e banka të ndryshme, bashkimit të shumave e rivendosjes për investime në vijim, kryesisht në vitet 2005, 2007, 2009, 2012, 2013 dhe 2014. Këto dy shuma, sipas përshkrimit në paragrafët 27-37 të vendimit, janë depozituar e lëvizur në harkun kohor që nis nga viti 2003.

10.5. Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, duke e konsideruar çmimin e blerjes sipas akteve të mësipërme noteriale, pasi ka rezultuar edhe që vlerat mesatare për shitblerjen e banesave në tregun e lirë, në qytetin e Tiranës, për këtë apartament rezultonin të përafërta me vlerën 73.000 euro. Përfundimisht, ndonëse në paragrafin 45 të vendimit, Komisioni shprehet për cenim të besimit të publikut, dhe për këtë pasuri rezulton të ketë konstatuar edhe deklaram të pasaktë, duke cituar edhe germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, në rubrikën përfundimtare, në përmbledhje të konkluzioneve për vlerësimin e pasurisë, në paragrafin nr. 87 të vendimit, referohet vetëm germa “b”, mungesë burimesh në paragrafin përmbledhës për pasurinë.

11.5. Në konsideratë të sa më sipër, nën dritën e garancive procedurale me ankimin, gjatë kontrollit të vendimit të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit mbajti të njëjtën linjë, duke e fokusuar shqyrtimin në analizën financiare të burimeve të deklaruara për krijimin e pasurive. Mospërputhjet e konstatuara në rrethanat si pasojë e të cilave është krijuar pasuria objekt analize, u bënë pjesë e vlerësimit për besueshmërinë e pretendimeve të subjektit dhe përgjithësisht të kriterit të vlerësimit të pasurisë, nën dritën e testit të përcaktuar nga neni 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, moskalimi me sukses i të cilit është një ndër kriteret përjashtuese të konfirmimit në detyrë.⁵

11.6. Komisioni nuk ka përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara për efekt të krijimit të kësaj pasurie shumë prej 400.000 lekësh, të deklaruara nga djali i subjektit të përfutur nga përdorimi i lojërave të fatit. Subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur shkaqe ankimi për këtë burim. Për pasojë, duke e konsideruar të pranuar këtë zë të analizës financiare, trupi gjykues nuk u ndal në analizë për këtë shumë. Përfundimisht, duke kryer analizën për pagesën e vlerës së pasurisë reflektuar në kontratën e shitjes, dhe pasi u ndal në të ardhurat e deklaruara nga subjekti nga aktiviteti bujqësor e blegtoral, zbriti shpenzimet e jetesës në më pak se ½ e atyre të referuara nga INSTAT për gjithë periudhën, përfshirë edhe vitet për të cilat subjekti nuk ka dekluar të ardhura nga bujqësia, dhe pasi analizoi *cash-in* e dekluar të kursyer, Komisioni konstatoi se subjekti ka një balancë negative për krijimin e pasurisë, përballimin e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve, në vlerën (-) 3.319.774 lekë, për harkun kohor 1993 – 2015.

11.7. Një pjesë me peshë në shkaqet e ankimit zënë të ardhurat nga *aktiviteti bujqësor*. Në pyetësin nr. 3 të Komisionit, subjekti është shprehur se shuma prej 5.200.000 lekë, përdorur për pagesat janë krijuar me të ardhurat nga paga e tij, të ardhurat nga toka bujqësore, punët e të cilave i ndiqte motra dhe nëna e tij, si dhe të ardhurat e bashkëshortes po nga ky aktivitet. Në deklaratën

⁵ “[1.] Konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet e mëposhtme: a) kur arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë [...]”.

vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore gjatë periudhës 1993 – 2016, në shumën 1.300.000 lekë. Subjekti ka deklaruar se dokumentacioni nuk disponohet i plotë për shkak të informalitetit. Në formularin e personit të lidhur, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore gjatë periudhës 1992 – 2016, në shumën 900.000 lekë, duke deklaruar se nuk disponon dokumente për shkak të informalitetit në këtë fushë. Në deklaratat periodike, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë filluar të deklarojnë të ardhura nga ky aktivitet vetëm duke filluar nga viti 2007 deri në vitin 2016. Nga krahasimi mes deklarimeve ndër vite me deklaratën *vetting*, rezulton se subjekti ka deklaruar në total të ardhura nga bujqësia 1.300.000 lekë, ndërsa bashkëshortja gjithsej ka deklaruar për të njëjtën periudhë të ardhura në masën 1.090.000 lekë, rreth 900.000 lekë më tepër sesa në deklaratën *vetting*.

11.8. Në pyetësin nr. 2, subjekti ka shpjeguar se veprimtaritë bujqësore dhe tregtimi i produkteve janë kryer në mënyrë informale, me pagesa në dorë, ashtu siç ka qenë praktika për të gjithë fermerët e zonës, dhe për këtë arsye nuk disponon dokumentacion financiar përkatës. Në vijim, subjekti ka shtuar se kjo situatë mbetet e njëjtë edhe aktualisht, ndërkohë që ligji për deklarimin e pasurive ka hyrë në fuqi vetëm në vitin 2003, ndaj nuk mund të kërkohej dokumentacion i tillë për periudhat pararendëse.

11.9. Në rezultatet mbi hetimin administrativ, Komisioni nuk përfshiu në analizën financiare të ardhurat e pretenduara nga subjekti si të krijuara nga bujqësia, për shkak se nuk konstatoi se subjekti arriti të provojë ushtrimin e aktivitetit, realizimin faktik të të ardhurave apo vlerën e tyre. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se në fshat kanë jetuar deri në vitin 1998, ku dhe ka kontribuar rregullisht, kurse nëna dhe motra deri në vitin 2002, kohë kur është shitur shtëpia në fshat. Subjekti i rivlerësimit sqaroi se i ka ndihmuar në çdo fundjavë. Ai potencoi se bashkëshortja është siguruar si e vetëpunësuar në bujqësi për periudhat 01.01.1993 – 31.12.1998 dhe 01.09.2004 – 31.12.2011, që kushtëzohet nga pagesa e taksës së tokës, dhe nënvizoi që të ardhurat e familje prej këtij aktiviteti nuk mund të mos përfshihen në tërësi. Subjekti po ashtu u shpreh se nuk janë deklaruar të ardhura për periudhën e mëhershme për faktin se ende nuk ka metodologji për të kryer llogaritjen nga institucionet shtetërore, pasi tregtimi i produkteve bujqësore e blegtorale ka qenë informal.

11.10. Subjekti pretendoi edhe se institucionet shtetërore të bujqësisë e kanë informuar se nuk mund të japin informacion zyrtar për të ardhurat për njësi toke që sigurohen nga familjet bujqësore. Për këtë shkak, ka kërkuar kryerjen e një ekspertimi vlerësues privat⁶ i cili me aktin e ekspertimit datë 17.07.2024, ka bërë vlerësimin e të ardhurave që *mund* të sigurohen nga toka bujqësore e subjektit të rivlerësimit. Sipas këtij akti ekspertimi, vlera totale e të ardhurave të krijuara nga bujqësia, për 25 vite [1992-2016] rezultoi në shumën 7,112,918 lekë. Sipas këtij akti janë kryer përlllogaritje mbi të ardhurat bruto që realizohen në këtë sipërfaqe toke (20.072 m²), me kërkesën e subjektit, gjatë viteve 1992 – 2016. Të dhënat e aktit të ekspertimit janë në nivel mesatar, referuar shpenzimeve për shërbime sipas tregut në secilin vit dhe çmimeve të shitjes së prodhimeve sipas kulturave.

⁶ Hartuar nga specialisti agronom, z. A. H.

11.11. Akti i ekspertimit i referohet një numri të madh të llojeve të prodhimeve bujqësore, të cilat janë kërkuar nga vetë subjekti i rivlerësimit për t'u përlllogaritur nga eksperti, situatë kjo, që krijon bindjen e trupit gjykues, se është realizuar qëllimisht nga eksperti në këtë mënyrë, për ta favorizuar subjektin e rivlerësimit. Për më tepër, akti i ekspertimit është në kundërshtim me atë që është deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike, për arsye se vlera e përfituar nga shitja e produkteve bujqësore që ka nxjerrë eksperti, është shumë më e lartë se ato që ka pretenduar subjekti se ka përfituar nga ky aktivitet.

11.12. Bashkë me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetim të datës 12.07.2024, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë (për të vetëpunësuarit në bujqësi), sipas të cilit bashkëshortja e tij figuron si e vetëpunësuar në bujqësi për periudhat 01.01.1993 – 31.12.1998 dhe 01.09.2004 – 31.12.2011, sipas kontributeve të derdhura për këto periudha.

11.13. Përpos sa më sipër përmbledhur, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar edhe të ardhura në vlerën 200.000 lekë nga shitja e kafshëve shtëpiake në kohën e shpërbërjes së kooperativës. Për ta provuar këtë pretendim, subjekti ka dorëzuar vërtetim nga kryetari i fshatit Ç., datë 15.07.2024, i cili konfirmon pretendimin e subjektit, dhe shprehet se familja e tij ka qenë banore e fshatit dhe që me shpërbërjen e kooperativës, të gjitha familjet kanë përfituar kafshë shtëpiake, lëndë drusore, ndërtesa, stalla etj. Ai deklaron se mban mend se në kohën kur anëtarët e familjes së subjektit u shpërngulën në B., kanë shitur të gjitha kafshët shtëpiake dhe shtëpinë.

11.14. Nga analiza e gjithë sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbysë barrën e provës për sasinë e të ardhurave të krijuara nga bujqësia. Pretendimet e tij mbetën deklarative. Për më tepër, në kushtet që edhe vetë subjekti *nuk* ka deklaruar të ardhura nga ky aktivitet deri në vitin 2007, apo që vlerat janë të ndryshme mes atyre në deklaratat periodike kundrejt deklaratës *vetting*, janë rrethana që dëshmojnë *më së paku* se sasia e përfituar nuk mund të ketë qenë në vlerat e qenësishme të pretenduara prej tij gjatë rivlerësimit. Për këto shkaqe, edhe akti i ekspertimit i sjellë prej tij në prapësim të barrës së provës, nuk ka vlerë provuese, qoftë edhe për vlerën e pretenduar nga subjekti në deklaratën *vetting*, ndërsa vlera thuhet në dyfishin e saj sipas atij dokumenti, ka mungesë thelbësore besueshmërie. Ky aspekt mban në konsideratë edhe që akti i ekspertimit është mbështetur mbi hipoteza për mundësinë e prodhimit të produkteve të ndryshme bujqësore nga toka, bazuar në kërkesën e subjektit të rivlerësimit dhe orientimin që i ka bërë ekspertit.

11.15. Fakti që as vetë subjekti nuk ka qenë koherent në specifikimin e sasisë së të ardhurave të krijuara, e bën të pamundur për rrjedhojë, të argumentohet se këto të ardhura janë materializuar në *cash-in* e depozituar ndër vite në banka [referuar më sipër]. Për më tepër, në kushtet që Komisioni gjithsesi ka përfshirë të ardhura nga bujqësia në një masë që ka përgjysmuar më së paku shpenzimet jetike, edhe për vitet pararendëse të vitit 2007 kur subjekti ka deklaruar të ardhura për herë të parë nga ky aktivitet, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në pikën fundore, zgjidhja e çështjes nga Komisioni për këto të ardhura ka qenë objektive dhe madje edhe favorizuese duke njohur parimisht kontributin lehtësues të këtij aktiviteti në ekonominë familjare.

11.16. Pavarësisht se subjekti nuk provoi të ardhurat në nivelin sasior – duke abstraguuar në tërësi nga analiza për kriterin e ligjshmërisë – akti i sjellë prej tij për të provuar se bashkëshortja e subjektit figuron e vetëpunësuar në bujqësi në periudhën kohore përkatëse, analizohet në funksion të këtij konkluzioni të Komisionit, si bazë dokumentare që provon më së paku një përfitim të vjelë nga familja e subjektit në sajë të shfrytëzimit të tokës bujqësore, krijimin e të ardhurave të pretenduara si të përfituara nga bujqësia. Vërtetimi i lëshuar nga kryeplaku i fshatit, në thelb të të cilit qëndron kujtesa e deklaruesit, duket që është hartuar në funksion të procesit të rivlerësimit të subjektit. Për rrjedhojë, këtij akti i mungon vlera provuese nën dritën e testit të pikës 4 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, për provat mbi të cilat mund të bazohen organet e rivlerësimit, analizuar në harmoni e në përputhje me aktet e besueshme. Edhe shlyerja e taksës vendore të tokës ndër vite, për të njëjtën analizë, provon vetëm që subjekti e bashkëshortja kanë poseduar tokë bujqësore dhe shlyer detyrimet ndaj buxhetit të shtetit, por duke mos qenë pagesa e kushtëzuar nga shfrytëzimi real i tokës për produkte bujqësore, nuk mund të pretendohet së provon më tepër sesa reflektohet në atë akt – që sipas subjektit duhet të përbëjë provën e shfrytëzimit dhe krijimit të likuiditeteve, përfshirë ato në depozita.

11.17. Për sa më sipër, konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Edhe në analizën e kryer në Kolegj, për këtë pasuri dhe për pasuritë e tjera të analizuara në vijim, për të cilat subjekti ka deklaruar si burim financiar të ardhurat e pretenduara si të fituara nga bujqësia, trupi gjykues vlerësoi për të mos i përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit. Ky konkluzion vlen edhe për pasuritë e tjera, krijimi i të cilave lidhet me verifikimin e burimeve financiare të ligjshme, të cilat kanë prejardhjen nga të ardhurat e pretenduara si të fituara nga produktet bujqësore.

11.18. Komisioni ka përllogaritur në vendim të ardhura nga interesat e depozitave në shumën totale 1.113.036 lekë. Nga verifikimi i kryer në Kolegj është e paqartë llogaritja e këtyre shumave nga Komisioni dhe për më tepër, mungon një diferencim i arsyetuar për pjesën e interesave që pasqyrojnë principalin e krijuar me të ardhura nga burime të ligjshme, kundrejt pjesës që nuk e përmbush këtë kriter. Në dritën e garancive procedurale me ankimin, trupi gjykues i Kolegjit i pranoi të mirëqena vlerat e pranuar e përllogaritura nga Komisioni. Duke konstatuar edhe një sasi të ardhurash të papërfshira të vitit 2016, kjo shumë do të korrektohej në vlerën 1.234.680 lekë, që përfshin interesat bankare për periudhën 2005 – 2015 nga depozitat bankare në emër të subjektit dhe familjarëve në Bankën Kombëtare Tregtare, Raiffeisen Bank, si dhe Union Bank, për periudhën 2005 – 2016.

11.19. Shpenzimet e udhëtimit, zëri tjetër i kundërshtuar me shkaqet e ankimit, rezulton të jenë përllogaritur në Komision në tabelën përmbledhëse financiare në vendim se zënë një shumë totale prej 359.309 lekësh. Subjekti ka pretenduar se shpenzimet duhej të ishin reduktuar me 214.042 lekë, në pesë (5) vite, në shuma që variojnë nga 100 deri në 850 euro për udhëtime jashtë,⁷ përfshirë

⁷ Subjekti ka kërkuar zbritjen e shpenzimeve të udhëtimit si vijon: Për vitin 2007, nga shpenzimet e llogaritura duhej të zritej shuma prej 850 eurosh për udhëtimet në Greqi dhe në Mal të Zi, dhe shpenzimet duhej të përllogariteshin në shumën 100,000 lekë, nga 114,865 lekë që janë llogaritur; Për vitin 2011, duhej të zritej shuma prej 627 eurosh për udhëtimin në Turqi, dhe nga shuma 145,593 lekë e llogaritur nga Komisioni, shpenzimet duhej të ishin përllogaritur në shumën 79,916 lekë, 65,677 lekë më pak; Për vitin 2012, duhej të zritej shuma prej 150 eurosh, ose rreth 20,000 lekë, në lidhje me udhëtimin në Prishtinë për pjesëmarrje në një seminar trajnues, nga 37,724 lekë që

një udhëtim pune në vitin 2012. Pas kontrollit të këtij shkakut ankimi, në Kolegj u evidentua se këto shpenzime janë përlogaritur sipas jurisprudencës dhe metodologjisë të përdorur në Kolegj, bazuar në të dhënat e sistemit TIMS dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe në parashtrime. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion mbështetës për të bazuar pretendimet për zbritje të këtyre shpenzimeve, përveç një udhëtimi në vitin 2012, ku ka paraqitur si dokumentacion provues një certifikatë pjesëmarrje për një trajnim të kryer në datat 5-6 dhjetor të vitit 2012, në Prishtinë. Referuar këtij fakti, trupi gjykues zbriti shpenzimin në shumën 150 euro për vitin 2012, duke vlerësuar se të dhënat janë të mjaftueshme për të provuar se ishte udhëtim zyrtar. Shpenzimet e udhëtimit për vitet e tjera u konfirmuan në vlerën e përlogaritur në Komision.

11.20. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* në shtëpi [kursime nga të ardhurat e familjes], në vlerën 350.000 lekë. Pasi ka analizuar këtë zë, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka deklaruar kursime *cash* vetëm duke nisur nga viti 2007 dhe po ashtu, se ai nuk ka deklaruar shtesa e pakësime. Përfundimisht, Komisioni ka konkluduar të përlogarisë shumat referuar deklaratave periodike, sipas përshkrimeve të subjektit në këto akte. Ndërsa balanca negative e konstatuar në rezultatet e hetimit për *cash*-in ka qenë në vlerën (-) 8.641.871 lekë, në vendim nuk ka një konstatim për një qëndrim përfundimtar për këtë aspekt, përpos një balance negative në paragrafin 84 të vendimit prej (-) 3.209.388 lekësh për periudhën 2003 - 2016.

11.21. Në ankim, subjekti kërkon që të përlogariten si shtesë kursimesh *cash*, balancat pozitive të viteve të rezultuara në analizën financiare. Subjekti argumenton se Komisioni ka llogaritur balancën negative për vitet 2003, 2007, 2011, 2013, 2014 dhe 2016, por nuk e ka kompensuar atë me balancën pozitive të viteve të tjera. Subjekti shprehet se ka qenë i paqartë dhe ka pasur pasaktësi në deklaratimet periodike lidhur me gjendjen *cash*. Ai pretendon se të ardhurat e viteve me bilanc pozitiv janë përdorur më pas për blerje autoveturash dhe për depozita kursimi. Mosdeklarimi i gjendjes *cash* ka ndodhur si pasojë e një gabimi njerëzor, pasi formulari i deklaratimit të pasurisë deri në vitin 2007, nuk e parashikonte këtë detyrim. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar analizën financiare të Komisionit, pa u ndalur në mënyrë të veçantë në llogaritjen e kursimeve *cash*. Ai ka argumentuar se Komisioni nuk i ka njohur në mënyrë të drejtë të ardhurat e përfituara nga toka bujqësore, si dhe elemente të tjera të analizës, që lidhen me shpenzimet familjare dhe krijimin e depozitave bankare.

11.22. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, për deklaratimet e *cash-it* dhe gjendjet në fund të vitit për periudhën 2007 - 2016, subjekti është shprehur se gjendja e likuiditeteve *cash* për këtë periudhë ka qenë e ndryshueshme, ndërsa si burim kanë shërbyer të ardhurat nga paga, të ardhurat e bashkëshortes, si dhe të ardhurat e përfituara nga toka bujqësore. Po ashtu, subjekti ka sqaruar se nuk është në gjendje të përcaktojë gjendjen konkrete në fillim dhe në fund të çdo viti kalendarik për periudhën e kërkuar, pasi nuk disponon dokumentacion dhe, në të kundërt, do të jepte deklaratime të pasakta. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, ka rezultuar se në vitin 2014, ILDKPKI-ja ka ushtruar kontroll mbi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit që nga viti 2003 deri

janë llogaritur; Për vitin 2014, duhej të zbritet shuma prej 100 eurosh për udhëtimin në Korfuz, ose rreth 13,500 lekë; Për vitin 2015, po ashtu, duhej të zbritet shuma prej 100 eurosh, ose rreth 13,500 lekë.

në vitin 2013. Subjekti ka paguar edhe një gjobë administrative në shumën 200.000 lekë, për deklarime të pasakta të likuiditeteve *cash*, mosdeklarim të gjendjeve të llogarive bankare në vite dhe mosmbulim të shpenzimeve dhe pasurive të deklaruara me të ardhurat e provuara me dokumentacion.

11.23. Sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), subjektet deklaruese kanë detyrimin të deklarojnë çdo shtesë të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, duke e përshkruar atë hollësisht dhe burimin e krijimit të saj. Në deklaratat periodike të viteve 2007-2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime nga paga, por pa specifikuar llojin e këtij kursimi (*cash* në banesë apo likuiditet). Shpjegimet në prapësime të rezultateve të hetimit, sipas së cilave ka sqaruar se *ka përdorur kursimet cash për rritje të depozitave dhe blerje automjetesh*, krijojnë një situatë e cila vështirëson kontrollin e rrjedhjes së gjendjes së *cash*-it ndër vite, duke devijuar edhe analizën financiare me alternativa të ndryshme. Ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarimit të pasurisë përcaktojnë detyrimin e subjektit deklarues të deklarojë në formën e përcaktuar prej tyre, dhe jo të zgjedhë mënyra të personalizuar për të kryer këtë detyrim ligjor. Forma e deklarimit nuk është trajtuar prej ligjit si një detyrim alternativ, i cili mbetet në vullnetin e subjektit, por një detyrim i mirëpërcaktuar, i cili duhet respektuar. Për më tepër në nenin 4, germa “d” e ligjit nr. 9049/2003 (varianti fillestar/ i pandryshuar) parashikon se subjektet deklarues deklarojnë vlerën e likuiditeteve, *gjendjen cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj. Sipas kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit duhej të deklaronte vit pas viti gjendjen *cash* në banesë, për të mundësuar kontrollin e pasurisë së tij.

11.24. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, nga sa më sipër nënvizuar, e nga analiza e akteve në fashikull, sikurse ka konstatuar edhe Komisioni, rezulton se për periudhën 2007 – 2016, subjekti ka deklaruar në deklaratat periodike përkatëse “shtesa nga paga vjetore”. Përkundër këtij qëndrimi, në prapësimet mbi rezultatet e hetimit subjekti është shprehur se kursimet *cash* janë krijuar kryesisht nga të ardhurat nga prodhimet bujqësore. Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ dhe në prapësime, subjekti ka pretenduar se ka përdorur kursimet *cash* për rritje të depozitave dhe blerje automjetesh, ndërkohë që kjo mënyrë administrimi e të ardhurave nuk ka gjetur asnjë pasqyrim ndër vite. Në deklaratat periodike përkatëse, në të cilat ka rubrika të dedikuara dhe udhëzim specifik për të konkretizuar burimet me të cilat krijohen pasuri të ndryshme, subjekti nuk ka pasqyruar mënyrën e veprimit që paraqet në hetimin administrativ. Konkretisht, në deklaratën periodike për vitin 2007, subjekti është shprehur se ka pasur të ardhura nga toka bujqësore dhe kursime nga paga në shumën 250.000 lekë. Në vijim, për vitet 2008 – 2015, ai ka deklaruar kursime nga paga dhe “shtesa në lekë” në vlera të ndryshme. Përpos këtyre detajeve, në deklaratën për vitin 2015, subjekti ka referuar edhe depozitë në bankë, në një vlerë të njëjtë me kursimet e vitit përkatës. Së fundi, në deklaratën për vitin 2016, subjekti ka shprehur qartësisht që nga shuma e të ardhurave familjare, 500.000 lekë janë kursime të vitit, prej të cilave 200.000 janë depozituar në një bankë, një pjesë tjetër në llogarinë e pagës, dhe tjetra në shtëpi.

11.25. Në vijim të kësaj analize, trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të bazuar konkluzionin e Komisionit. Në linjë me arsyetime të mëparshme për subjekte të tjerë⁸, trupi gjykues i Kolegjit, edhe në këtë rast, çmon të rikonfirmojë rëndësinë kyçe që marrin deklaratat periodike vjetore në përlllogaritjen e kursimeve në formën e likuiditeteve *cash* në procesin e rivlerësimit, sidomos për shkak se janë i vetmi akt nëpërmjet të cilit subjektet deklarues sipas ligjit, dokumentojnë kursimet në likuiditete jashtë sistemit bankar. Ato përbëjnë dokument të hartuar nën përgjegjësinë e ligjit, nëpërmjet të cilit edhe organet e rivlerësimit hartojnë analizat financiare për efekt të pasurive e shpenzimeve. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime gjatë viteve 2003 – 2006 në deklaratat periodike. Për rrjedhojë, nën dritën e gjuhës dhe frymës së ligjit, janë të pabazuara pretendimet e tij gjatë hetimit administrativ për të përlllogaritur kursime për vitet që ai nuk ka deklaruar të tilla, dhe kërkimi që të përlllogariten si të kursyera balancat pozitive që rezultojnë nga analizat financiare teorike të kryera nga Komisioni për të krijuar një panoramë në funksion të krijimit të pasurive objekt analize.

11.26. Pretendimi i subjektit se Komisioni ka rillogaritur gabimisht shpenzimet jetike për vitin 2014 në një masë më të lartë se vitet e tjera, dhe për pasojë ka sjellë artificialisht një balancë negative, është i pabazuar. Sikurse theksuar edhe më sipër, Komisioni ka reduktuar shpenzimet e jetesës në masën 47.6%, duke pranuar si të provuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit në një fazë të avancuar të hetimit, në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, për shpenzime më të ulëta si pasojë e jetesës në fshat e mbështetur edhe nga veprimtaria familjare bujqësore në vite, për të gjithë periudhën, përfshirë edhe vitin 2014. Kolegji korrektoi vetëm shpenzimet për numër anëtarësh për vitet 2005 e 2006, në të cilat Komisioni ka llogaritur shpenzime jetike për gjashtë (6) persona, ndërkohë që sipas certifikatës rezultojnë pesë (5) anëtarë të familjes. Shuma e saktë u pasqyrua në analizën financiare të korrigjuar në Kolegj.

11.27. Subjekti ka pretenduar edhe që është llogaritur dy herë e njëjta shumë [1.189.846 lekë] si likuiditet, duke passjellë gabim dhe thelluar rezultatin negativ për periudhën 1993 –2002 si dhe për vitin 2003. Nga kontrolli i vendimit të Komisionit në Kolegj, u konstatua se zëri “Likuiditete total” dhe ai “Ndryshim likuiditeti”, për periudhën 1993 – 2002 dhe vitin 2003, kanë të njëjtën shumë, ndërkohë që kjo e fundit duhet të ishte 389.846 lekë. Ky lapsus ka ndikuar në rezultatin financiar të periudhës 1993 – 2002, si dhe për vitin 2003. Duke e gjetur të drejtë këtë pretendim, Kolegji korrektoi analizën financiare për këtë periudhë.

11.28. Trupi gjykues korrektoi shumën e likuiditeteve të deklaruara në vitin 2003, duke marrë në konsideratë gjendjen e tyre, përkatësisht me efekt në analizën për vitet 1993 – 2002 dhe 2003. Nga ky korrektim, ndonëse u zvogëlua balanca negative e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, ajo gjithsesi mbeti e konsiderueshme. Në këtë analizë, sikurse edhe Komisioni, trupi gjykues e gjeti të bazuar vlerësimin e Komisionit për mënyrën e përlllogaritjes së likuiditeteve *cash* të kursyera, bazuar në deklaratat periodike vjetore.

⁸ *Shih, ndër të tjera, vendimin e Kolegjit në çështjen e subjektit të rivlerësimit Xh. Z., nr. 19/2019 (JR) ose D. P.) nr. 27/2020 (JR).*

11.29. Në përfundim të analizës më sipër, dhe kontrollit të ushtruar nga Kolegji analizës financiare të Komisionit, sikurse shtjelluar më sipër -- duke mos përfshirë të ardhurat e pretenduara nga prodhimet bujqësore, gjendjen *cash* sipas deklarimeve periodike në ILDKPKI, si dhe duke konsideruar çmimin e apartamentit në shumën 5.600.000 lekë, aq sa është konsideruar në Komision -- dhe me korrektimet për lapsusin në përlllogaritje dhe një prej viteve për shpenzimet e jetesës sipas përbërjes familjare, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë për blerjen e apartamentit në vitin 2015, me burime financiare të ligjshme, për diferencën negative në shumën -1,973,181 lekë, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

B.2. Shtëpi banimi dhe truall me sipërfaqe 400 m² në B.

12. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dy herë në deklaratën *vetting*, 4.688 m² tokë arë, 160 m² pemëtores dhe 115 m² vresht, të ndodhura në fshatin Ç., Rrethi Devoll, fituar me ligjin nr. 7501/1991, “Për tokën”, dy herë. Herën e dytë si burim subjekti ka përcaktuar trashëgiminë nga nëna në vitin 2004. Subjekti ka deklaruar gjithashtu shtëpi banimi, së bashku me truallin 400 m² me vendndodhje në B., fituar me trashëgimi nga nëna [znj. M. P.] Pasi kreu analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni konkludoi se subjekti e familjarët nuk kanë arritur të provojnë mundësinë financiare të krijimit të pasurisë gjatë kohës kur subjekti ushtronte detyrën për shkak të një balance negative prej (-) 821.700 lekësh në harkun kohor 1993 - 1997. Për këtë arsye, Komisioni ka konstatuar se subjekti gjendet në kushtet e germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

12.1. Subjekti ka kundërshtuar këtë konkluzion, duke theksuar se analiza financiare në Komision duhej të kryhej në mënyrë të pandarë për të gjithë periudhën, nga viti 1993 deri më 31.12.2002, dhe jo të fragmentuar në dy periudha (1993 - 1997 dhe 1998 - 2002). Kjo mënyrë ishte më e përshtatshme, sipas tij, pasi deri në vitin 2002 nuk ekzistonte detyrimi ligjor për deklarim pasurie. Një pjesë e shkaqeve të ankimit për këtë pasuri, lidhet me zëra të analizuar e shtjelluar gjerësisht më sipër për pasurinë tjetër. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit kundërshton mospërfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të të ardhurave bujqësore e blegtorale, megjithëse familja e tij ka përfituar tokë e pasuri nga ish-kooperativa (tokë arë, vreshta, kafshë shtëpiake) dhe ka siguruar të ardhura të qëndrueshme deri në vitin 2002. Po ashtu, subjekti potencon kundërshtime edhe për përlllogaritjen e kryer nga Komisioni për interesat bankare për periudhën 1993 – 2002. Gjithashtu, subjekti pretendon se depozitat bankare nuk janë përlllogaritur saktë, pasi Komisioni nuk ka marrë në konsideratë shpjegimet e tij për pamundësinë e gjetjes së dokumentacionit nëpërmjet të cilit provohen depozitimet në ish-Bankën e Kursimeve që nga viti 1993 dhe interesat e fituara në vite deri në vitin 2002. Së fundmi, subjekti argumenton nevojën për një përlllogaritje të ndryshme të kostos së ndërtimit të shtëpisë. Ndryshe nga sa ka përlllogaritur Komisioni, shprehet subjekti, ndërtimi ka kushtuar rreth 500.000 lekë, pasi materialet kryesore ishin pasuri të familjes, të përfituara nga shpërbërja e kooperativës bujqësore, dhe shumica e ndërtimit ishte realizuar nga familjarët dhe të afërmit e tij.

12.2. Trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të bazuar e të drejtë vlerësimin e Komisionit për koston e investimit, bazuar në çmimet e miratuara nga Enti Kombëtar i Banesave, për vendin dhe kohën

kur është kryer ndërtimi. Pavarësisht korrektiveve të kryera nga Kolegji, balanca negative u zbut me një vlerë të papërfillshme për të ndryshuar në mënyrë përcaktuese situatën financiare, në shumën (-) 759,474 lekë. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk provuan mundësinë financiare për krijimin me burime të ligjshme të kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

12.3. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorëve, për mënyrën e krijimit, vlerën e investimit dhe burimin financiar të krijimit të kësaj pasurie, subjekti është shprehur se toka është blerë me kontratë noteriale datë 10.03.1997, kundrejt çmimit prej 200.000 lekësh. Nga aktet rezulton se leja e ndërtimit për shtëpinë është lëshuar më 02.05.1997, me vendimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit në Devoll. Sipas dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, datë 07.04.2005, subjekti është bërë trashëgimtari i vetëm i nënës së tij për pasurinë objekt analize, sikurse edhe i një fondi në lekë të depozituar në Bankën e Kursimeve Bilisht, si dhe çdo pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme që mund të vijë në të ardhmen nga trashëgimlënësja. Së fundmi, sipas informacionit të dërguar Komisionit nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, është bërë bashkimi i dy pasurive, truallit 400 m² dhe ndërtesës 122 m² në një pasuri të vetme. Për këtë pasuri është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie datë 26.01.2023.

12.4. Komisioni kreu analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie sipas dokumentacionit të administruar prej tij, duke marrë në konsideratë të ardhurat e provuara me dokumentacion për periudhën 1993 – 1997. Ndërsa në rezultatet e hetimit, Komisioni ka referuar vlerën e shtëpisë dhe truallit sipas referencës në vlerën 1.938.500 lekë, dhe konstatuar për pasojë një balancë negative të burimeve të ligjshme prej thujse 78% të çmimit [1.520.389 lekë], në vendimin përfundimtar ky zë është ulur ndjeshëm, në (-) 821.000 lekë. Komisioni ka pranuar pretendimet e subjektit pjesërisht, duke përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara edhe të ardhurat nga pagat e tij si ndihmës gjyqtar dhe gjyqtar në harkun kohor dhjetor 1993 deri në dhjetor 1998. Komisioni, po ashtu, ka pranuar kërkesën e subjektit për të zbritur nga kostoja e ndërtimit sipas çmimeve të referencës zëra të caktuar që bashkërisht arrijnë në 35% të kostos [shpenzime për tatimin mbi vlerën e shtuar, fitimin dhe fondin rezervë], duke e pranuar të mirëqenë pretendimin e subjektit se ndërtimi është kryer informalisht. Si pasojë e kësaj qasjeje, vlera e ndërtimit është përlllogaritur në 1.330.025 lekë në total. Nën dritën e jurisprudencës së Kolegjit, të ardhurat e subjektit nga pagat në vitet 1985 deri në 1992 nuk janë përfshirë në analizën e burimeve financiare të disponuara.

12.5. Në ankim, subjekti pretendon se të ardhurat për vitet 1993 – 1997 duhej të ishin më të larta, ndërsa shpenzimet më të ulëta. Në prapësime, subjekti pretendoi se për periudhën 1992 – 1997, të ardhurat që duhet të llogariten gjithsej duhet të jenë në shumën 2.626.424 lekë, për atë, bashkëshorten dhe pensionin e nënës. Subjekti ka kërkuar edhe përfshirjen e të ardhurave nga paga e tij si agronom përpara së të bëhej pjesë e gjyqësorit dhe të ardhurat e familjes bujqësore (1992-1997 sipas specifikimeve të ekspertit të marrë prej tij). Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar kundër qëndrimit për të provuar me dokumentacion të ardhurat. Mungesa e dokumentacionit, sipas tij, nuk duhet të passjellë konkluzionin që familja nuk ka siguruar asnjë të ardhur bujqësore e blegtorale për periudhën 1991–1997 e në vijim. Duke

referuar ngjarje që lidhen me ndarjen e pronave të kooperativave bujqësore në vitet 90', me barrën e provës, subjekti ka kërkuar që, për efekt të burimeve financiare të disponuara prej tij, të përfshihet përfitimi nga shpërndarja e pasurive të përbashkëta për secilën familje bujqësore, dhe përdorimi i tyre sipas nevojave. Duke qenë familja e tij bashkëpronarë në pasurinë e fituar, edhe nëse nuk do të kontribuonte, duhet t'i njiheshin të ardhura referuar dispozitave të Kodit Civil, nenet 222 e vijues, mbi familjen bujqësore dhe bashkëpronësinë.

12.6. Gjatë hetimit administrativ dhe në fazën e ankimit, subjekti ka mbajtur qëndrimin se vlera e ndërtimit të objektit është dukshëm më e vogël se ajo e përcaktuar nga Komisioni, rreth 500.000 lekë pasi ndërtimi është realizuar me kontributin e familjarëve dhe të afërmeve, pa shpenzime të konsiderueshme financiare, çka e bën koston faktike shumë më të ulët se ajo e llogaritur sipas tarifave të Entit Kombëtar të Banesave. Të gjitha materialet e ndërtimit si gurë, tulla e lëndë drusore, kanë qenë të familjes, nga objektet e fituara nga shpërbërja e ish-kooperativës bujqësore. Çmimet e referencës për koston e ndërtimit nuk duheshin bazuar në vlerën për qytetin e Korçës, pasi Bilishti klasifikohet si kategoria e tretë. Kostoja kryesore ka qenë për blerjen e tjegullave të çatisë dhe punë krahu. Subjekti ka argumentuar se shtëpia është e thjeshtë dhe ka dhënë detaje ilustruese përse kostoja ka qenë minimale.

12.7. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se referimi tek kostot e EKB-së përbën një qasje të drejtë e objektive. Referuar të dhënave për vitin 1997, kostoja e ndërtimit për qytetin e Korçës për një sipërfaqe ndërtimore prej 122 m², rezultoi në shumën totale prej 1.738.500 lekësh. Ky referim përbën standard të arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi. Për më tepër, duke mbajtur në konsideratë që Komisioni ka zbritur edhe 35% të koston së kësaj reference të vetme zyrtare, kërkimi i subjektit për ta reduktuar çmimin edhe më tej, është i pabazuar pasi është në tërësi deklarativ. Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për të provuar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij. Ai nuk ka paraqitur as bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting* dhe as përgjatë hetimit administrativ, dokumentacion justifikues i cili do të provonte pretendimet për shpenzime në vlerën 500.000 lekë – që përbën 28% të çmimit të referencës – përpos argumenteve me natyrë të përgjithshme për materiale ndërtimi të përfituara si pasojë e shpërbërjes së kooperativës, apo për strukturë bazike të banesës.

12.8. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se nga aktet në fashikull, konkretisht leja e ndërtimit⁹, rezulton se objekti është marrë përsipër të ndërtohet nga një person juridik [{"***"}] ShPK]. Ky fakt, më së paku, nënkupton që pretendimet deklarative të subjektit për ndërtim informal – pa shpenzimet e zbritura që në total përbëjnë 35% të vlerës së koston së referencës – bien ndesh me aktet, e për pasojë, analiza financiare do të duhet të bazohet në koston e çmimeve të referencës. Mungesa e hetimit tërësisht për të zbardhur kontradiktat mes akteve dhe pretendimeve, dhe mungesa në tërësi e arsytimit për shkaqet për të cilat, pavarësisht nga ky detaj i shprehur, Komisioni ka zgjedhur të bazohet në pretendimet deklarative të subjektit, në kundërshtim me detyrimin ligjor që parashikon paragrafi 4¹⁰ i nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, tregon

⁹ Shih shkresën nr. {***} prot., formulari nr. 4 i KRRt Devoll, pjesë e fashikujve të Komisionit.

¹⁰ “[4.] Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]”.

për një qëndrim që gjithsesi ka qenë më favorizuesi i mundshëm. Duke mbajtur në konsideratë gjithë sa më sipër, nën dritën e garancive procedurale me ankimin, në analizën e kryer në Kolegj trupi gjykues u bazua në vlerën e reduktuar të kostos së ndërtimit, pranuar nga Komisioni.

12.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, Kolegji vlerësoi se të ardhurat nga pagat dhe pensionet për periudhën 1993 – 1997, nga 906.754 lekë të përlllogaritura sipas Komisionit, duhej të ishin në vlerën 815.072 lekë, ndërsa shpenzimet e jetesës të përlllogaritura nga Komisioni janë në shumën 398.429 lekë, duhej të ishin në shumën 244.522 lekë. Nga ana tjetër, pretendimi i subjektit për ta shtrirë analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie përgjatë periudhës së viteve 1993 - 2002, është i pabazuar. Në kushtet që pasuria është krijuar në vitin 1997, kërkimi i subjektit për të përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara, edhe të ardhurat familjare të krijuara pasi është blerë trualli dhe ndërtuar shtëpia, janë të pakuptimta.

12.10. Pretendimi i subjektit për interesa bankare në vitet 1993 – 2002, të cilat duhet të shtohen në analizën financiare, është po ashtu deklarativ. Subjekti nuk ka provuar me ndonjë dokument pasjen e një depozite përpara vitit 2000 dhe në aktet në fashikull nuk rezulton asnjë përpjekje e pasuksesshme e tij për të gjetur dokumentacion, që të mund të analizohej për efekt të pamundësisë objektive sipas ligjit. Për pasojë, ekzistenca e këtyre të ardhurave nga interesat apo depozitat e krijuara nga familja e subjektit për periudhën 1993 – 1999, mbetën në nivel deklarativ.

12.11. Arsyetimi i mësipërm i trupit gjykues për të ardhurat nga bujqësia, për pasurinë tjetër [apartamentin në Tiranë], vlen edhe për këtë pasuri. Pa përsëritur sa është shtjelluar gjerësisht më sipër, Komisioni ka pranuar një vlerë të konsiderueshme të ardhurash nga bujqësia, në kushtet që ka zbritur shpenzimet e jetesës për më tepër sesa 50% e standardit zyrtar të përdorur nga INSTAT, që është objektiv dhe përfshin vlerë modeste dhe mban në konsideratë edhe shpenzimet e grupeve demografike më vulnerabël të shoqërisë shqiptare. Për këto arsye, ky pretendim edhe parë në kontekstin e kësaj pasurie, u vlerësua i pabazuar.

- 13.** Si rrjedhojë e konkluzioneve të mësipërme, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar në germën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Mungesa e burimeve të ligjshme për të dy pasuritë për të cilat Komisioni ka konkluduar për masën disiplinore, në vlerat përkatësisht (-) 1.973.181 lekë dhe (-) 759.474 lekë, ose në total (-) 2.732.655 lekë, tregon një balancë negative e cila përjashton mundësinë e zbatimit të parimit të proporcionalitetit. Për më tepër, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë që kjo shumë është versioni më i favorshëm i mundshëm për kontrollin e pasurisë së subjektit, sipas analizës dhe konstatimeve të shtjelluara më sipër në këtë vendim.
- 14.** Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Seladin Pysqyli gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 788, datë 25.07.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 788, datë 25.07.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Seladin Pysqyli.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 11.02.2026, në Tiranë.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi